



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 852 / prot. 13

Tiranë, më 05.12.2025

**VENDIM**  
Nr. 65, datë 05.12.2025

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 52, DATË 20.9.2024**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 52, datë 20.9.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Memaliaj dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë",

**KONSTATOVA SE:**

Me Urdhrin nr. 58, datë 22.05.2024, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Memaliaj", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, në institucionin Bashkia Memaliaj.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 52, datë 20.09.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Memaliaj dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës", ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me Urdhrin nr.88, datë 13.10.2025, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr.52, datë 20.9.2024, në institucionin Bashkia Memaliaj, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes në vazhdim nr.852/1, datë 13.10.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Memaliaj me shkresën nr.852/2, datë 13.10.2025, "Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit nr. 52 ,datë 20.9.2024 të Komisionerit".

Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes dhe në përfundim të procesit, mbajti një procesverbal, ku u evidentua situata në lidhje me ecurinë e masave të marra nga institucioni.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.52, datë 20.9.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, konstatohet se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në **pikën 2-5**, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar që Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të organizojë dhe kryejë një proces të plotë të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil; të hartohen përshkrimet e punës; të krijohet komiteti për vlerësimin dhe klasifikimin e këtyre pozicioneve; të administrohet dokumentacioni i nevojshëm dhe të përgatitet një listë përmbledhëse e pozicioneve të punës të klasifikuara sipas kategorisë dhe klasës përkatëse, në përputhje me ligjin dhe vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Nga dokumentacioni i administruar, konstatohet se, me urdhrin nr. 2170/1 prot., datë 14.10.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm, është ngritur Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve të punës të shërbimit civil, si strukturë përgjegjëse për administrimin e procesit të vlerësimit dhe klasifikimit.

Në vijim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Bashkisë Memaliaj, me shkresën nr.2170/2 prot., datë 15.11.2024, ka njoftuar të gjithë njësitë përbërëse të institucionit për mbledhjen dhe analizimin e informacionit mbi pozicionet e punës në strukturën aktuale të shërbimit civil, me qëllim hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës. Kjo shkresë i është dërguar për dijeni edhe Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit. Sipas përfaqësuesve të burimeve njerëzore të institucionit dhe verifikimit në subjekt, përshkrimet e punës janë hartuar vetëm për pozicionet që janë të lira. Grupi i punës administroi me anë të përzgjedhjes përshkrimet për dy pozicione pune: *Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Kadastrës dhe Specialist i Burimeve Njerëzore.*

Nga ana e përfaqësuesve të burimeve njerëzore, u pretendua se është bërë ndarja ndërmjet pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, punonjësve administrativë dhe funksionarëve të kabinetit, në strukturë, por nga këqyrja e strukturës dhe organikës së institucionit, të miratuar me vendimin nr. 9, datë 29.1.2025, "Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë dhe strukturave të tjera.", të Kryetarit të Bashkisë, u vunë re një sërë problematikash në lidhje me emërtesat e pozicioneve, ku disa pozicione me emërtesën "Specialist", ishin lënë jashtë shërbimit civil dhe ndërkohë, pozicione me emërtesën "Punoniës", ishin konsideruar si pjesë e shërbimit civil.

Në **pikën 6** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar që, pasi të përcaktohen përfundimisht pozicionet e punës, klasat dhe emërtesat për secilën kategori, të hartohet dhe miratohet një plan rekrutimesh në shërbimin civil ku të shpallen për konkurrim të gjitha vendet vakante, duke përfshirë edhe ato të plotësuara në kundërshtim me ligjin. Njëkohësisht, Kryetari i Bashkisë të konstatojë pavlefshmërinë të 5 akteve të emërimeve të kundërligjshme.

Nga verifikimi në subjekt, vërej se është hartuar plani i rekrutimit në shërbimit civil me vendimin nr. 117, datë 4.8.2025, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj por në këtë plan nuk janë përfshirë të gjitha pozicionet e plotësuara me emërime të përkohshme, të cilat në kuptim të ligjit konsiderohen si vakante.

Përsa i përket 5 rasteve të konstatimit të pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit, për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligj, në pozicione pune të kategorisë ekzekutive, situata paraqitet si më poshtë:

- **Anxhela Isomati**, pas procedurës së konkurrimit është emëruar nëpunës civil në periudhë prove me aktin nr.155, datë 24.10.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist Tatim-Taksash*”;
- **Elton Cana**, me aktin nr. 141, datë 11.10.2024, të titullarit, i është bërë ndërprerja e marrëdhënieve të punësimit;
- Pozicioni “*Specialist i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, për qytetin Memaliaj*” nuk ekziston më në strukturën aktuale.
- Pozicioni “*Specialist turizmi*” ka dalë jashtë fushës së veprimtarisë së shërbimit civil.
- Pozicioni “*Specialist finance*”, në Drejtorinë e Shërbimeve vazhdon të jetë në kundërshtim me ligjin.

Në **pikën 7** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit të nxjerra në kundërshtim me ligjin për 6 punonjësit e emëruar në pozicione pune të shërbimit civil.

Në lidhje me rastet e emërimit në kundërshtim me ligjin në pozicione të kategorisë së lartë, të mesme dhe ulët drejtuese konstatohet se situata paraqitet si më poshtë:

- **Emigerta Elmazi**, në përfundim të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 131, datë 1.9.2025, të titullarit, është emëruar në pozicionin “*Sekretare e Përgjithshme*”.
- Me vendimin nr. 96, datë 5.6.2025, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit për punonjësin **Saimir Meçe**;
- Me aktin nr. 76., prot., datë 28.2.2025, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit për punonjësin **Baftjar Xhaferi**;
- Me vendimin nr. 119, datë 2.8.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit për punonjësen **Jorida Çaushi**.

- Për punonjësen **Lavdie Doda**, emëruar me aktin nr. 37, datë 07.02.2024, të titullarit, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Integritimit European, projekteve dhe Turizmit”, është bërë ndërprerja e marrëdhënieve të punësimit pasi ishte emëruar për një afat 3- mujor.
- Për punonjësin **Beqar Xhaferi**, emëruar me aktin nr. 77, datë 13.05.2024, të titullarit, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Bijqësisë, Blegtorisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit vazhdon pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit.

Në **pikën 8** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar që, për pozicionet “*Specialist protokoll*” në bashki dhe “*Magaznier & arkivist protokollist*” në Drejtorinë e Shërbimeve, Njësia e Burimeve Njerëzore dhe eprori direkt të përcaktojnë qartë detyrat, përgjegjësitë dhe kërkesat ligjore të këtyre funksioneve, duke u bazuar në ligjin dhe orientimet e raportit përfundimtar. Nëse pas vlerësimit rezulton se këto pozicione kanë tiparet e shërbimit civil, atëherë të qartësohet emërtimi i saktë i pozicionit dhe të përgatitet përshkrimi i plotë i punës me të gjitha kërkesat dhe përgjegjësitë përkatëse.

Nga verifikimi në subjekt, u konstatua se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e kësaj detyre.

Në **pikën 9** të vendimit paralajmërues Komisioneri ka kërkuar që Komisioneri ka kërkuar që procedura e konkurrimit për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Financës*” të korrigjohet duke anuluar fazën e dytë të procesit dhe aktet e nxjerra në kundërshtim me ligjin, të krijohet një Komitet i ri i Pranimit për Ngritjen në Detyrë që do të zhvillojë saktë këtë fazë dhe të realizohen të gjitha veprimet e tjera ligjore deri në emërimin e kandidatit që do të shpallet fitues sipas procedurës së rregullt.

Sipas përfaqësuesve të burimeve njerëzore në institucion ky pozicion në strukturën aktuale ka kaluar në Agjencinë e Shërbimeve, jashtë shërbimit civil.

Në **pikën 10** të vendimit, Komisioneri ka kërkuar që eprori direkt të zbatojë plotësisht procedurën ligjore për vlerësimin e nëpunësve që ndodhen në periudhë prove, duke caktuar mbikëqyrësin përkatës, duke kryer vlerësimin e detajuar të performancës me notë dhe komente, si dhe duke marrë një vendim të arsyetuar për konfirmimin, zgjatjen ose moskonfirmimin e nëpunësit, bazuar në rezultatet e trajnimit dhe vlerësimet e kryera, duke e njoftuar si nëpunësin, ashtu edhe njësinë përgjegjëse.

Vërej se, njësia përgjegjëse (*njësia e burimeve njerëzore të institucionit*) ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në përfundim të periudhës së provës për konfirmimin e nëpunësve civilë.

Rezulton se:

- Me aktin nr. 1873/1 prot., datë 28.8.2025, Mikel Saliu, është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës;
- Me aktin nr. 368/2 prot., datë 18.2.2025, Teki Alia, është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin, “*Specialist Prokurimesh*”.

Në **pikën 11** të vendimit paralajmërues Komisioneri ka kërkuar që njësia përgjegjëse të plotësojë dhe përditësojë plotësisht dosjet e personelit, duke siguruar dokumentet e detyrueshme si gjendja gjyqësore, raporti mjekësor dhe gjithë dokumentacioni i parashikuar në lidhjet 1 dhe 2 të Vendimit nr. 833/2020, në mënyrë që çdo dosje të jetë e rregullt dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

Nga verifikimi në subjekt, u konstatua se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e kësaj detyre.

Në **pikën 12** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Njësia përgjegjëse të hartojnë dhe miratojnë një plan veprimi për zbatimin e vendimit paralajmërues, i cili të përmbajë: veprimet administrative që do të ndërmerren, personat përgjegjës për realizimin e tyre dhe afatet konkrete për përfundimin e secilit veprim.

Nga verifikimi në subjekt, u konstatua se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e kësaj detyre.

**Në përfundim**, në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, rezulton se Bashkia Memaliaj ka filluar zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 52, datë 20.9.2024, të Komisionerit, nëpërmjet veprimeve konkrete administrative, për të gjitha detyrat e lëna, por ende nuk e ka përfunduar atë. Problematika në këtë rast, qëndron kryesisht në drejtim të dy aspekteve të administrimit të shërbimit civil, që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil dhe rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, edhe pse, nga institucioni janë marrë masa për t'i nisur dhe zhvilluar këto procese, por ende ato nuk janë finalizuar me akte përfundimtare.

Në kushtet kur këto procese kanë një nivel kompleks vështirësie që kërkon njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore si edhe kapacitete të mjaftueshme në përbërje dhe mbështetje të njësisë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore të institucionit, të cilat janë të kufizuara në njësitë e administratës vendore, e sidomos në këto bashki me një numër relativisht të ulët banorësh, e po kështu, duke njohur faktin se këto procese kërkojnë një periudhë kohore relativisht të gjatë për t'u implementuar, si për shkak të afateve procedurale, ashtu edhe për arsye të ndryshme objektive, që kryesisht qëndrojnë në mungesën e kandidatëve të interesuar për të marrë pjesë në procesin e rekrutimit, vlerësojmë se për realizimin e detyrave, institucionit duhet t'i mundësohet një afat kohor që shkon përtej atij të vendosur nga Komisioneri në vendimin e paralajmërimit.

Me synim plotësimin e detyrave të lëna në vendim, në koherencë edhe me zhvillimet aktuale, që përkojnë me hartimin e strukturave të reja organizative të njësive të administratës vendore për vitin 2026, si edhe me qëllim që këto institucione të mbështeten me asistencë teknike si nëpërmjet trajnimeve nga ASPA, ashtu edhe nga stafi i Komisionerit, për të zbatuar drejt kërkesat e ligjit dhe procedurat ligjore rast pas rasti, vlerësojmë se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë, përgjatë vitit 2026, duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe mbikëqyrjes së orientuar për implementimin e

skemës së administrimit të shërbimit civil në përbërje të strukturës organizative në njësitë e vetqeverisjes vendore, të cilat janë procese që aktualisht realizohen nga stafi i Komisionerit, përgjatë gjithë vitit kalendarik.

Në këto kushte, vlerësoj se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 52, datë 20.9.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Memaliaj dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë".
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Memaliaj.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

